

# STATUTI

## I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR BRAIAN 2019

### THEMELIMI I SHOQERISE

Neni 1

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "BRAIAN 2019" sh.p.k. eshte themeluar me aktin e themelimit te dates 13.12.2019, bazuar ne kerkesat e ligjit Nr 9901 date 14.04.2008 "Per shoqerite Tregtare".

### EMERTIMI

Neni 2

Emertimi i tregetar i Shoqerise eshte "BRAIAN 2019" sh.p.k.  
Inicialet SHPK jane te nevojshme te perdoren ne logo ose per qellime reklame.

### SELIA

Neni 3

Selia e shoqerise tregtare me pergjegjesi te kufizuar "BRAIAN 2019" sh.p.k. eshte ne Lezhe, Njesia Administrative Kolsh, fshati Manati, Godine Private e Edmir Boci 3 KT, kati i pare, Pasuria Nr 135/13, z.k 2588. ajo do te hape filiale dhe ne rrethe te tjera brenda dhe jashte vendit.

### KOHEZGJATJA

Neni 4

Kohezgjatja e veprimtarise ekonomike te shoqerise eshte mbi 10 vjet.

### OBJEKTI I VEPRIMTARISE

NENI 5

Objekti i veprimtarise ekonomike te shoqerise "BRAIAN 2019" sh.p.k. është:

- Eksport-import dhe tregtim i mineraleve te kromit, lendeve te para dhe ndihmese per prodhimin e ferrokromit brenda dhe jashte vendit.
  - Shfrytezim i mineraleve te kromit, magazinimi ne depo i lendeve plasese dhe shperthyese si dhe ruajtja e tyre per perdorim civil.
  - Perdorimi i lendeve plasese dhe shperthyese ne kryerjen e punimeve per hapjen dhe shfrytezimin e mineraleve ne karrjera e nentoke per perdorim civil.
  - Shfrytezim, perpunim dhe tregtim me shumice dhe pakice i lendes drusore. Tregtim me shumice e pakice, import-eksport te mallrave te ndryshme ,industriale, te artikujve bujqesore, ushqimore, duralumini, metaleve, hidrosanitare etj.
  - Ne fushen e transportit te mallrave me mjetet e vete shoqerise per llogari te saj dhe per llogari te treteve.
- Si dhe çdo aktivitet i lejuar me ligj

### KAPITALI I SHOQERISE

Neni 6

Kapitali themelor i shoqerise eshte ne masen 3.000.000(tremilion)leke, i ndare ne 1 kuotë me 3'000'000 leke kuotat e te cilit jane te ndara ne :

- 1- Z. Edmir Boci                      100% ose 3.000.000 leke ose 1 kuotë

## **TRANSFERIMI I KUOTAVE TE KAPITALIT**

Neni 7

1-Ne rastin e transferimit te kuotave te kapitalit, ortakut qe kerkon te shese kuotat e tij te kapitalit duhet te njoftoje me shkrim adminsitratorin i cili njofton menjehere Asamblene e ortakeve per cmimin e shitjes se kuotave te ortakut qe kerkon ti shese.

2- Cmimi i kuotave oferte per shitje duhet te vendoset ne baze te vleres reale te Shoqerise ne momentin e dhenies se te drejtes. Ortaket e tjere mund ti blejne ne raport me kuotat ekzistuese duke ruajtur nje njejtat raporte me kuotat qe posedojne secili.

3- Ne qofte se brenga 30 diteve nga komunikimi i ofertes per shitje te kuotave te kapitalit te shoqerise asnjeri nga ortaket e shoqerise nuk shprehet per blerjen e tyre atehere Kuotat oferte shitje mund ti transferohen cdo personi qe kerkon ti bleje.

## **TRANSFERIMI TEK PJESETARI I FAMILJES**

Neni 8

Pjeset e kapitalit jane lirisht te transferueshme mes bashkeshorteve si dhe mes paraardhesve dhe pasardhesve. Transferimi i pjeses se kapitalit mes bashkeshortesh ne rast ndarjeje pasurie gjithashtu nuk kufizohet.

## **TRANSFERIMI I PJESES SE KAPITALIT NE RRUGE TRASHEGIMIE**

Neni 9

Pjeset e kapitalit jane te trashegueshme pa asnje kufizim sipas ligjit per Trashegimine.

## **FORMA E TRANSFERIMIT TE PJESEVE TE KAPITALIT**

Neni 10

Kontrata per transferimin e pjeses se kapitalit duhet te jete ne formen e aktit noterial dhe ne rast se pronari i ri nuk eshte ortak i shoqerise, duhet te deklaroje shprehimisht ne kontrate se eshte njohur me aktin e themelimit te shoqerise dhe statutine shoqerise dhe se eshte dakort me aktin e themelimit dhe statutin e shoqerise.

## **RRITJA E KAPITALIT THEMELOR**

Neni 11

Kapitali themelor mund te rritet pa kufizim ne cdo moment dhe nje ose disa here me votim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve votues present apo perfaqesues qe permbajne me shume se  $\frac{3}{4}$  e te kapitalit themelor. Ne rastin e shqyrtimit te rritjes se kapitalit, te gjitha ortaket kane te drejten te nenshkruajne rritjen sipas kuotave qe posedojne, ne rast se nuk e ushtrojne kete te drejte, kuotat e tyre mund te nenshkruhen nga ortaket e tjere ne menyre proporcionale sipas pjesemarrjeve perkatese.

## **REDUKTIMI KAPITALIT THEMELTAR**

Neni 12

1-Kapitali themeltar mund te reduktohet me Vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve, me votim te ortakeve prezente apo perfaqesuesve qe perfaqesojne me shume se  $\frac{3}{4}$  te kapitalit te shoqerise.

2- Reduktimi i kapitalit te shoqerise perballohet nga secili ortak ne menyre proporcionale sipas kuotave qe zoterojne. Asamblea mund te vendose reduktimin e kapitalit te shoqerise brenda limiteve te ligjit, qofte edhe nepermjet ortakeve te veten apo grupe ortakesh, aktivitetesh te shoqerise apo aksioneve ose kuotave te shoqerive te tjera ne te cilat shoqeria ben pjese.

## **TE DREJTAT DHE DETYRIMET E ORTAKEVE**

Neni 13

1. Ortaku ka te drejte te informohet lidhur me administrimin e shoqerise, te njihet me bilancin vjetor dhe te kerkoje me shkrim sqarime te cilat i jep administratori i mbledhjen e asamblese.
2. Secili nga ortaket ka te drejte t'i kerkoje gjykates qe te heqe nga funksioni administratorin i cili ka shkelur ligjin.
3. Secili ortak qe nuk eshte administrator, ka te drejte ti paraqese me shkrim dy here ne vit administratorit pyetjet lidhur me problemet, egzistenca e te cilave ve ne dyshim vazhdimesine e aktivitetit te shoqerise. Lidhur me pergjigjen e administratorit vihen ne dijeni edhe eksperti kontabel i autorizuar.
4. Ne rast se shoqeria nuk ka ekspert kontabel te autorizuar, atehere emerimi i nje eksperti kontabel te autorizuar mund te kerkohet ne rruge gjyqesore nga nje ose disa ortake, pjeset e kapitalit te te cileve perfaqesojne te pakten 5% e kapitalit themeltar.
5. Nje ose disa ortake, pjeset e kapitalit te te cileve se bashku perfaqesojne 5% e kapitalit themeletar, mund te kerkojne ne rruge gjyqesore caktimin e nje ose disa eksperteve te ngarkuar per paraqitjen e nje raporti per nje apo disa veprimtari administrative. Raporti i ekspertit i dorezohet ortakut/ortakeve qe ka bere kerkesen, administratorit, eventualisht eksperteve kontabel te autorizuar, ne qofte se jane emeruar, raporti paraqitet ne mbedhjen e ardhshme te asamblese.
6. Ortaku nuk mund te marrre hua nga shoqeria, te miratoje ne emer te shoqerise paradheniet ose te behet garant per detyrimet ndaj personave te trete. Ne rast te kundert veprimi eshte i pavlefshem, kjo vlen edhe per perfaqesuesit ligjore te tij, bashkeshortin si dhe per paraardhesit e pasardhesit e tij.
7. Ortaku, qe eshte person juridik, eshte i detyruar qe menjehere te njoftoje ortaket e tjere lidhur me ndryshimet e statutit ose te perberjes se organeve te tij.

## **PERFAQESIMI I SHOQERISE**

Neni 14

- 1-Asambleja e Ortakeve
- 2-Administratori

## **ASAMBLEJA**

Neni 15

Organi vendimor i shoqerise eshte Asambleja e Ortakeve. Vendimet e saj me shumice pengojne ortaket qe mungojne apo te papajtueshem, pervec rasteve te te drejtes se tyre te kundershimit te ushtruar ne raste, afate apo forma te parashikuara ne ligj.

## **KOMPETENCAT E ASAMBLESE**

Neni 16

Asambleja eshte organi me i larte vendimor i shoqerise i cili vendos per :

- Mosmiratimin e veprimeve te ortakeve themelues perpara rregjistrimit te shoqerise.
- Miratimin e bilancit vjetor, ndarjen e fitimit dhe menyren e ndarjes se humbjeve te shoqerise.
- Zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit themelor.
- Ndryshimin e aktit themelues ose statutit.
- Emerimin, heqjen dhe shperblimin e administratorit dhe te ekspertit kontabel te autorizuar.
- Prishjen e shoqerise
- Ceshtje te tjera te cilat ky statut i le ne komptentece te tij.

## **MBLEDHJA E ASAMBLESE DHE VOTIMI**

Neni 17



1. Asambleja e pergjithshme mblidhet ne rastet e percaktuara nga ligji 9901 dt. 14.04.2008, ose nga dispozitat e statutit dhe sa here qe mbledhja eshte e nevojshme per te mbrojtur interesat e shoqerise. Mbledhja e zakonshme e asamblese se pergjithshme thirret te pakten nje here ne vit.
2. Asambleja e pergjithshme thirret nga administratoret apo ortaket e percaktuar sipas nenit 84 te ligjit 9901 dt. 14.04.2008.
3. Asambleja e pergjithshme thirret nese, sipas bilancit vjetor apo raporteve te ndermjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku qe aktivet e shoqerise nuk i mbulojne detyrimet e kerkueshme brenda 3 muajve ne vazhdim.
4. Asambleja e pergjithshme thirret kur shoqeria propozon te shese apo te disponoje ne menyre tjeter aktive, te cilat kane nje vlere me te larte se 5 perqind te aseteve te shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuar.
5. Asambleja e e pergjithshme thirret kur shoqeria, brenda 2 viteve te para pas regjistrimit te saj, propozon te bleje nga nje ortak pasuri, qe kane vlere me te larte se 5 perqind te aseteve te shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare e certifikuara.
6. Ne rastet e parashikuara ne pikat 3 e 5 te ketij neni, asamblese se pergjithshme i paraqitet nje raport nga nje ekspert kontabel i autorizuar, i pavarur.
7. Dispozitat e pikes 6 te ketij neni nuk zbatohen nese blerjet, sipas pikave 4 e 5 te ketij neni, kryhen ne burse ose jane pjese e veprimeve te perditshme te shoqerise dhe behen ne kushte normale tregu. Gjithashtu, keto dispozita nuk zbatohen ne rastin kur shoqeria zoterohet nga nje ortak i vetem.
8. Ne rastet e parashikuara ne pikat 3 deri ne 5 te ketij neni, asambleja e pergjithshme mund te miratoje nje rezolute keshilluese, duke miratuar apo bere verejtje per veprimtarine e administratoreve.
9. Vendimet ne mbledhjen e asamblese ose pas konsultimit me shkrim merren nga nje ose disa ortaket qe perfaqesojne me shume se tre te katertat e kapitalit themelor. Ky numer votash mjafton edhe per ndryshimin e statutit te shoqerise.

#### **ADMINISTRATORI**

##### **Neni 18**

Shoqeria perfaqesohet nga administratori.

Ne emer te shoqerise firmos administratori i cili i bashkangjit emertimin tregetar te shoqerise emrin, mbiemrin dhe funksionin e tij.

#### **EMERIMI I ADMINISTRATORIT**

##### **Neni 19**

Administratori i Shoqerise do te jete **Edmir Boci** i cili emërohen nga asambleja e Ortakeve me shumicen e votave te ortakeve, pjeset e te cilave perfaqesojne te paktën me shume se 50% e kapitalit themeltar te shoqerise, administratori mund te jete ortak ne shoqeri ose jo.

Administratori **Edmir Boci** emerohet per 3 vjet me te drejte perseritje.

#### **KOMPETENCAT E ADMINISTRATORIT**

##### **Neni 20**

1. Administratori ka te drejte te veproje ne emer te shoqerise ne marredhenie me persona te trete persa i perket te gjitha ceshtjeve me perjashtim te atyre qe ligji ose ky statut i le ne kompetence te Asamblese.

2. Administratori ka per detyre ne kuadrin e kompetencave te tij te siguroje mbajtjen e rregullt te evidences dhe llogarise sipas ligjit, te mbaje listen e te gjithe ortakeve dhe te informoje ortaket lidhur me ceshtjet qe i takojne shoqerise.

3. Administratori ka per detyre te ngreje stafin drejtues dhe te pajtoje punemarres ne shoqeri ne funksionet qe ai i sheh te arësyeshme dhe nenshkruan kontratat e punes me punemarresit.

### **DETYRAT E ADMINISTRATORIT**

Neni 21

1. Administratori i shoqerise ka detyre te kryeje funksionin e tij me kujdesin e duhur dhe te ruaje sekretin lidhur me informacionet dhe faktet konfidenciale, transmetimi i te cilave te persona te trete mund te shkaktoje deme per shoqerine. Detyrimi per te ruajtur sekretin vazhdon edhe mbas perfundimit te funksionit te administratorit.

2. Administratori pergjigjet per demin, te cilin e shkakton nga veprimet e kryera prej tij ne dem te shoqerise.

3. Administratori nuk mund te marre hua nga shoqeria, te miratoje ne emer te shoqerise paradheniet ose te behet garant per detyrimet ndaj personave te trete. Ne rast te kundert veprimi eshte i pavlefshem, kjo vlen edhe per perfaqesuesit e tij ligjore, bashkeshortin si dhe per paraardhesit apo pasardhesit e tij.

4. Administratori ka detyre qe te paken nje here ne vit t'i paraqese asamblese raportin mbi aktivitetin e shoqerise dhe gjendjen e pasurise se tij.

5. Administratori pergatit dhe i paraqet asamblese raportin lidhur me marreveshjen mes atij ose nje ortaku dhe shoqerise. Ortaku qe eshte pale e marreveshjes nuk mund te votoje ne mbledhjen e asamblese. Administratori ose ortaku qe nenshkruajne nje marreveshje pa miratimin e asamblese, i pergjigjen shoqerise per demin e shkaktohet si pasoje e kesaj marrveshjeje.

### **USHTRIMI VJETOR I SHOQERISE , BILANCI VJETOR, NDARJA E FITIMIT**

Neni 22

1- Viti ushtrimor i aktivitetit te shoqerise mbyllet me daten 31-dhjetor. Ne fund te vitit ushtrimor administratori procedon me hartimin e bilancit me llogaritjen e fitimit dhe humbjes sipas normave te ligjit, duke e shoqeruar me nje relacion shtese per aktivitetin e shoqerise.

2-Çdo ortak ka te drejte te kete nga Administratori lajme mbi zhvillimin e puneve te shoqerise dhe te konsultohet me librat e shoqerise.

### **NDARJA E FITIMIT**

Neni 23

Fitimet neto qe rezultojne nga bilanci vjetor, reduktuar me 5% (pese perqind) te destinuar per rezerven ligjore, qe arrin deri ne 10% te kapitalit te shoqerise, si edhe reduktimet eventuale te percaktuara nga Asamblea, shperndahen ndermjet ortakeve ne raport me kuotat e kapitalit qe zoteron secili.

### **ZGJIDHJA E MOSMARREVESHJEVE**

Neni 24

Te gjitha mosmarreveshjet qe mund te lindin gjate kohes se ushtrimit te veprimtarise se shoqerise nga interpretimi, zbatimi dhe zgjidhja e Aktit te Themelit dhe Statutit te shoqerise si dhe ne pergjithesi te gjitha

mosmatrreveshjet e ortakeve, apo midis nje ortaku dhe shoqerise ne parim do te zgjidhen me mirekuptim dhe ne baze te aktit te themelimit dhe statuti, ne rast mungese te mirekuptimit zgjidhja i besohet gjykates Shqiptare kompetente.

### SHKRIRJA E SHOQERISE Neni 25

Shoqeria shkrihet :

- ditën e shenuar ne Vendimin e Asamblese per shkrirjen e shoqerise.  
- ditën e shenuar ne vendimin e gjykates per shkrirjen e shoqerise  
- ne raste te tjera, te cilat vendosen me ligj.


### GJUHA Neni 26

Ky statut eshte redaktuar ne Lezhe me date 13.12.2019 ne kater kopje origjinale ne Gjuhen Shqipe .

### DISPOZITA TE FUNDIT Neni 27

Persa nuk eshte shprehur ne kete statut eshte komptence e Asamblese se Ortakeve qe te beje plotesimin e dispozitave te ketij statuti, si dhe shfuqizimin e atyre dispozitave te cilat behen te pavlefshem dhe jo-efektive dhe keto ndryshime do te behen ne formen e nje dokumenti noterial.

### ORTAKU THEMELUES Edmir Boci

*Edmir Boci*  


REPUBLIKA E SHQIPERISE  
DHOMA E NOTEREVE SHKODER  
ZYRA E NOTERISE LEZHE  
Nr 4585 Rep

### V E R T E T I M

Sot me daten 13.12.2019 ne zyren e noterise ne Lezhe para meje noterit Vasil Gj.Martini u paraqit personalisht: **Edmir Boci** me atesi Pal dhe amesi Flora, i lindur ne Lezhe me 20.04.1986 me banim ne Lezhe, madhor me zotesi te plote per te vepruar, i identifikuar me leternjoftim me Nr 031482409/ 160420068C i cili me deklaroi se Statutin e mesiperm te perpiluar jashte kesaj zyre e nenshkruan me vullnetin e tyre te lire dhe te plote para meje noterit dhe une duke e gjetur ne rregull nenshkrimin e tij dhe te bazuar ne ligj e vertetoj.

**NOTER**  
Vasil Gj. Martini



